

V E N D I M
Nr.122 datë 6.3.1993

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.526 DATË
20.12.1958 "PËR NDARJEN E PUNËVE NË KATEGORI PËR EFEKT PENSIONI"**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.526 datë 20.12.1958, në pasqyrën nr.1 të punëve që hyjnë në kategorinë e parë, bëhen këto shtesa:

Shtohet kreu XV me këtë përmbajtje : Punët e avaro-shpëtimit në miniera.

- Punëtorë avaro-shpëtues në miniera.

Në kreun III - Punët në fabrikat e pasurimit të mineraleve të bakrit, kromit dhe fonderitë.

Shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

- Punëtorët të mirëmbajtjes dhe remontit.

Në kreun IX - Punët në industrinë kimike.

a) Në uzinën e nitrat-amonit, pas pikës 3, shtohen pikat 4,5,6,7 me këtë përmbajtje:

4. Punëtori i komprimimit të gazit metan, azot, ajër+oksigen+amoniak, gaz karbonik, metan+ajër.

5. Punëtori i mirëmbajtjes dhe i remontit në repartin e kompresorëve.

6. Punëtori i turbinës në repartin e prodhimit të acidit nitrik (turbinist).

7. Punëtori në pompat e presionit të lartë dhe në postin e sintezës së uresë, punëtori i remontit dhe i mirëmbajtjes të pajisjeve në repartin e uresë.

Në kreun IX – Punët në industrinë kimike, pas shkronjes “b” shtohen:

c) Në uzinën e PVC.

1. Në repartin e elektrolizës

- Teknolog vaske, punëtor i mirëmbajtjes dhe remontit të makinerive e pajisjeve me zhivë, rregullimit të tensioneve të vaskave të elektrolizës, mirëmbajtjes së çelësave, punimeve të destilimit të zhivës dhe të demerkurizimit të ujërave.

2. Në repartin e klorit dhe polimer-klorivinilit

- Punëtor ambalazhues të hipokloritit.

- Punëtor i kompresorëve në klorovinil, punime kryesore e ndihmëse në katalizator, i drejtimit të pultit të komandimit në polimer, i punimeve kryesore e ndihmëse në polimerizim të aparatit të centrifugës.

ç) Ndërmarrja e prodhimit të kripës së detit.

1. Punëtor i prodhimit të kripës së detit, fugist, punëtor bartës.

Në kreun VIII – Punët në industrinë e bakrit, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c", punët në uzinën e telave.

1. Petëzues dhe regjistruues (kolaudues) i linjës së ashpër e të pastër të bakrit.

Kreu XIII - Punët në uzinën e petëzimit në kombinatin metalurgjik në Elbasan, ndryshohet me këtë përmbajtje:

XIII. Punët në metalurgjinë e zezë e ferrokrom.

a) Në uzinën e petëzimit

- Pikat 1, 2, 3 nuk ndryshojnë.

b) Në uzinën e gizës

- Në repartin e furnaltës.

- Punëtor dhe ndihmës të topit elektrik.

- Punëtorë të shërbimit të kanalit të derdhjes së gizës dhe skorjes.

Në fabrikën e aglomerimit.

Në repartin e pjekjes.

- Punëtor në sitën e nxehë të aglomerimit.

- Punëtor në transportierin 19 (nëntokësor).

- Punëtor i copëtimit të aglomerimit.

Në repartin e lëndës së parë në fabrikën e aglomerimit.

- në depon e koncentratit (26-PJ-1) vinçier të vinçit "grefer" punëtor i gazrave.

Në repartin e lëndës së parë në furnaltë.

- Punëtor i transportierit BA-88-9 (nëntokësor).

Në repartin e makinës së derdhjes (obj.45).

- Punëtori i shërbimit të ullikut.

c) Në uzinën e çelikut

Në repartet e shkrirjes (konverta e furrat elektrike me hark).

- Shkrirës të reparteve furra elektrike me hark, konverta e kova lëkundëse.

- Punëtor derdhës i çelikut me konkile.

- Punëtor derdhës i çelikut në makinat e derdhjes së pandërprerë të kovës 25 tonëshe të kovës ndërmjetëse, drejtues i derdhjes.

- Punëtor i platformave, punëtor i montim-çmontimit të konkileve.

ç) Në uzinën nr.12

Në repartin e finjzimit.

- Punëtor i pastrimit të kolonave dhe dekantuesve.

d) Në uzinën kokso-kimike

- në repartin e koksifikimit.

- Punëtor i kapakëve të ngarkimit.

- Makinist e ndihmësmakinist i ngarkimit.

- Teknolog i tubave vertikale.

- Punëtor i pastrimit të dritave.

- Makinist i vagonit të shuarjes së koksit.

- Teknolog i rregullimit të temperaturave.

- Teknolog i matjes së temperaturave.

- Punëtor remonter dritaresh.

- Mekanik i detaleve të nxehta.

dh) Në ndërmarrjen karbonike

1. Punëtor i reparteve kryesore teknologjike (makinistë e teknologë).

e) Në uzinën e nikel-kobaltit

- Punëtor i teknologjisë së shkrirjes, derdhjes dhe elektrolizës.

f) Punët në uzinat e ferrokromit

- Punëtor i ngarkesës së furrës me lëndë të para e masë elektrode të drejtimit të procesit teknologjik (kuota 5 ml/ e furrës) të derdhjes së metalit të shkrirë, vinçier i derdhjes së masës së shkrirë, derdhjes e shkrirjes së bronzit, zhbllokimit të kovave, linjës së granulimit të skorjes, saldator i procesit teknologjik të furrave.

Në pasqyrën nr.2 të punëve që hyjnë në kategorinë e dytë të bëhen ndryshime e shtesa.

Në kreun XXXII – Punët me lëndë radioaktive dhe burime rrezatimi jonizues, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. Punëtorët e laboratorit që punojnë me rrezet “X” e ultratinguj në repartet teknologjike (rengenolog. difektoskop) kampionmarrës dhe kryerës i analizave të gazit.

Në kreun II – Punët në miniera në sipërfaqe shtohet pika 6:

6. Shpetuesit dhe inspektorët e repartit të inspektim-shpëtimit të minierave, komandanti i repartit.

Në kreun V – Punët në industrinë e naftës (në sektorin e përpunimit të naftës shtohet shkronja "d" "Punët në kombinatin e PTHN").

1. Impianti i distilimit atmosferik.

- Teknolog, fugist, pompist, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.

2. Impianti i koksifikimit.

- Teknolog, fugist, kompresorist, pompist, sodist, punëtor bankoporte, vinçier, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.

3. Impianti i hidropastrimit të karburanteve.

- Teknolog, pompist, kompresorist, fugist, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.

4. Impianti i hidrogenit dhe i platformingut.

- Teknolog, fugist, kompresorist, pompist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.
 - 5. Impianti i pastrimit të gazit dhe i prodhimit të squfurit e solventit.
 - Teknolog, pompist, punëtor i formimit, të squfurit, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.
 - 6. Reparti i transportit të naftës e gazit.
 - Teknolog, pompist, punëtor i përgatitjes së sodës, dispeçer, manovrues, kryemanovrues, punëtor kalese, punëtor i mbushjes së bombolave të gazit dhe i kolaudimit të tyre, punëtor i mbushjes së cisternave e autobotëve, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.
 - 7. Reparti i ujëngrohjes dhe laborator i kimik i karburanteve e vajrave.
 - Teknolog, pompist, kompresorist, mirëmbajtës, punëtor i marrjes së kampioneve dhe i përpunimit kimik, përpunues qelqi, përgjegjës ndërrese.
 - 8. Repartet e ruajtjes, transportit të vajrave, reagentëve kimikë e lëndëve djegëse, larjes, mbushjes e manipulimit të fuçive, elektrik, remontit të rezervuarëve.
 - Teknolog, pompist, motorist, mbushës i fuçive dhe autobotëve, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese, elektrovinçier, marketues i fuçive, bojaxhi i lyerjes së rezervuarëve, mekanik, montator, saldator, kipist në ndërresë, mirëmbajtës elektrik e telefonik, mirëmbajtës i nënstacioneve në repart, që punojnë me ndërresa.
 - 9. Impiant i distilimit në vakum të vajrave lubrifikante me propan i vajrave lubrifikante, ekstraktimit me furfuroli të vajrave lubrifikante.
 - Teknolog, fugist, pompist, kompresorist, turbopompist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.
 - 10. Impiantet e deparafinimit, hidropastrimit të vajrave lubrifikante.
 - Teknolog, pompist, kompresorist, fugist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.
 - 11. Impianti i prodhimit të propanit e parafinës dhe përzierjes së vajrave lubrifikante.
 - Teknolog, pompist, punëtor i ambalazhimit të parafinës, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese, elektrovinçier.
 - 12. Repartet e remontit mekanik, mirëmbajtës, të inspektimit, shpëtimit e kontrollit teknik.
 - Punëtorë të riparimit të pompave, kompresorëve e pajisjeve statike që punojnë me ndërresa, shpëtues, laborantë të analizave, bojaxhinj, përgjegjës repartit, inxhinierë në impiantet dhe repartet teknologjike.
- Kreu XXVIII - Punët në industrinë kimike në shkronjen "a" shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
8. Punëtor i prodhimit të uresë, qarkullimit, granulimit, distilimit, absorbimit dhe avullimit, punëtor i komprimimit të ajrit për aparatet e kontrollit matës, punëtor i remontit e mirëmbajtjes së makinerive e pajisjeve teknologjike në repartet e prodhimit të uresë dhe laborant i procesit teknologjik të prodhimit.
- Po kështu në këtë kre, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:
- dh) Në uzinën e PVC
1. Reparti i elektrolizës
- Punëtor i drejtimit të pultit të komandimit, përpunimit të ujërave me zhivë, të përpunimit e filtrimit të shëllirave, shllamit e sodës kaustike, pompist dhe të furnizimit me kripë.
- Përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e elektrolizës.
2. Reparti i përpunimit të klorit.
- Punëtor operator i përpunimit të klorit, hidrogjenit, lëngështimit e mbushjes së klorit, absorbimit e debsorbimit, vëzhguesi i furrës së sintezës, ambalazhimit të acidit klorhidrik, pompist i acidit klorhidrik dhe absorbues i klorit të pashfrytëzuar.
3. Sektori i hipokloritit
- Punëtor punimesh për përgatitjen kimike të gëlqeres, transportues me elevator i gëlqerorës, absorbues prodhimi të hipokloritit, pompist i hipokloritit.
 - Mekanik mirëmbajtës në repartin e përpunimit të klorit.
 - Përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e përpunimit të klorit.
4. Reparti i klorivinil polimer
- Punëtor i drejtimit të pultit të komandimit në konvertor, në retifikim, punëtor konvertues, ratifikues.
5. Sektori i polimerit
- Punëtor i zbutjes së ujit filtrues e pompës operator në sallën e komandimit, në punime kryesore në tharje, dekantues e përpunues në polimerizim, mbushës e paketues i PVC-së, punonjës në laboratorin e repartit të klorivinilit të polimerit.

- Mekanik mirëmbajtës në repartin e klorivinil-polimerit.
- Përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e klorivinil-polimerit.

6. Reparti i oksigjen-ftohjes.

- Punëtor në punime kryesore në kolonën e ratifikimit, kompresorist ajri, kompresorist azoti, kompresorist ajri të thatë, kompresorist oksigjeni, mbushës i bombolave të oksigjenit, ngarkim-shkarkimi i bombolave.

7. Sektori i ftohjes

- Punëtor në punime kryesore e ndihmës në drejtimin e sistemit -35 gradë culcius.
- Mekanik mirëmbajtës në repartin e oksigjen ftohjes.
- Përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e oksigjenit të ftohtë.

Në kreun XXVII – Punët në industrinë e bakrit, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

c) Punët në uzinën e telave

1. Punëtor i ngrohjes së kallëpëve të bakrit ngarkesës së furrës, pritjes së kallëpëve të nxehtë, lidhjes e peshimit të katankës, deoksidues i katankës me H₂SO₄, prodhim gurrkali, pulti i komandimit në petëzimin e bakrit, zdrukthues i kallëpëve, lubrifikues në petëzim, telëzues i telave të trashë të bakrit dhe aluminit.

2. Saldator i telëzimit të trashë, kallaisjes së telave, përgatitjes së emulsit teknologjik zmallimit të telave, përgatitjes së llakut, regjenerimit të PVC-së, mekanik, elektrik i mirëmbajtjes në petëzim, zmallim e telëzim.

3. Përgjegjës ndërrese në repartet e mësipërme.

Kreu XXXII/1 Punët në uzinën e petëzimit të kombinatit metalurgjik në Elbasan, ndryshohet me këtë përmbajtje:

XXXII/1 – Punët në metalurgjinë e zezë e ferrokrom

a) Në uzinën e petëzimit

- Pikat nga numri rendor 1-15 nuk ndryshojnë.

b) Punët në uzinën e nikel-kobaltit

- përgjegjës ndërrese, teknolog reparti në repartet teknologjike të uzinës.

c) Në uzinën e gizës

Në repartin e furnaltës

- Punëtor komandues dhe kontrollues i sistemit të ushqimit.
- Punëtor të sistemit ftohës të furnaltës.
- Punëtor komandues dhe kontrollues i furnizimit të furës nën bunker.
- Punëtor të marrjes dhe përpunues të gazit të furnaltës.
- Punëtor të drejtimin të procesit teknologjik (drejtues e ndjekës të procesit teknologjik në furnaltë).

- Mekanik të sistemit hidraulik.

Në fabrikën e aglomerimit

- Punëtor të copëtuesit.
- Punëtor të përzierësit të parë dhe të dytë.
- Punëtorë të kontrollit të flakës.
- Punëtor të sistemit ftohës.
- Punëtor në transportierët nr.1, 5, 6, 8, 18 e kthim 22-23, 24, 25, 26, 27, 28-29 me zinxhir dhe transportier nr.8 në objektin 226.

Reparti i lëndës së parë (furnaltë).

- Punëtorët e sitave, komandues dhe ndihmëskomandues të copëtuesit, komandues të sistemeve të transportierëve.
- Punëtor të shërbimit në depo.

Në repartin e ajër-gazit

- Punëtor e ndihmës në ajërngrohës.
- Punëtor në objektin 34.
- mekanik, elektrikist, hidraulik që punojnë për mirëmbajtjen, riparimin dhe remontet e reparteve metalurgjike e kimike në uzinë.
- Muraturë dhe ndihmësmuraturë të kovave të gizës.
- përgjegjës ndërrese, teknolog ndërrese në repartet teknologjike të uzinës.

- Shpëtuesit në uzinë.

d) Në uzinën e çelikut

Në repartin e konvertave

- Punëtorët e sistemit të ftohjes së gazit, punëtorë të pastrimit të gazit në konvertë dhe të sistemit të pastrimit të gazit në kovëlëkundje.

- Vinçierë të aksit të skorjes (AB), vinçierë të aksit të shkrirjes së çelikut (reparti, furra elektrike me hark, shkrirje konvertë, kovalëkundëse e mikser), vinçierë të aksit të derdhjes së çelikut (reparti furra elektrike me hark, konvertë, derdhja me konkile, makina të derdhjes së pandërprerë, vinçierë, montim-çmontim konkileje).

- Punëtorët e transportit të objektit 63 në repartin e konvertave.

- Punëtorët e manovrimit të elektrodave në repartin e furrave elektrike me hark.

- Punëtorë të zhbllokimit të konkilejeve, të repartit me gur zmeril të lingotave e prokateve të çelikut.

Në derdhjen e pandërprerë

- Punëtorët derdhës të rafinimit të çelikut lëng, derdhës i lubrifikimit të çelikut lëng, derdhës i ftohjes së prokatit, manovrator i drejtimit të prokatit dhe i pultit të komandimit.

- Punëtorët e brigadës së pastrimit të mjediseve teknologjike në korpusin e çelikut, oksigjenistët e prerjes së kupolave e akrepit të ngurtësuar me rrymë oksigjeni.

- Punëtor i zhbllokimit të kovave të skorjeve në korpusin e çelikut.

Në repartin e dolomit-gëlqeres.

- Punëtorët në objektin 51 (të përgatitjes së kapakëve termoizoluese në derdhjen e çelikut), përzierësit, pjekësit, formistët e kapakëve termoizolues, copëtuesi me nofulla, punëtor në objektin 49, përzierësit, dozuesit, përgatitësit e pluhurave egzotermike të prodhimit të lëngut të xhamit.

- Punëtorët në objektin e prodhimit të tullave dolomite, përzierësit e dolomitit, punëtorët e furrës ngrohëse, në presën e tullave në platformën vibruese, në objektin 48, trajtuesit, përgatitësit dhe copëtuesit e ferrolidhjeve.

Në punime të tjera

Në repartin konverte e furra elektrike me hark.

- Murator dhe ndihmësmurator në konvertë, murator dhe ndihmësmurator në furra elektrike me hark, murator dhe ndihmësmurator kovëlëkundës, në kovat e derdhjes 25 kovat ndërmjetëse të derdhjes së pandërprerë, murator të mikserit, të remonteve të furrave metalurgjike, termike, kovave të gizës e çelikut.

- Mekanik, elektrikist, hidraulik, frigoriferist që punojnë në mirëmbajtje e remonte të linjave, agregatëve e pajisjeve metalurgjike, kimike e lëndëve të para.

- Oksigjenistët e prerjes së metalit me kanellë.

- Përgjegjës ndërrese, teknolog ndërrese në repartin e konvertave e furrave elektrike me hark.

dh) Në uzinën nr.12

Në repartin përgatitor

- Punëtor në repartin përgatitor (duke përjashtuar operatorin në sallën e komandës të objektit 102, dhe pompistët e objektit 128).

- Mekanist në sitat vibruese.

Në repartin e pjekjes

- Punëtorë në repartin e pjekjes (duke përjashtuar pompistët në kuotën zero dhe operatorët e sallave të komandimit të objekteve 124, 127, 129, pompistët e pompave të ujit objekti 125).

- Teknolog në pluhurkapëset e furrës ngrohëse.

- Punëtorë të elektrofiltrave (elektrecist, makinist, teknolog).

Në repartin e finjzimit

- Gjithë punëtorët e repartit të finjzimit

Në repartin e koncentratit

- Gjithë punëtorët e këtij reparti, duke përjashtuar sallën e komandës së objektit 223.

Në repartin e karbonatit bazik të nikelit.

- Gjithë punonjësit e këtij reparti, duke përjashtuar teknologët në filtër presat.

Në repartin e gazit

- Gjithë punonjësit e repartit të gazit.

- Punëtorët mekanike, elektrikistë, muratorë, punëtorë të përgatitjes së sulfatit të aluminit të

dërgimit të acidit sulfurik në repartet metalurgjike e kimike.

- Përgjegjës e inxhinier ndërrese në repartet metalitgjike e kimike.

e) Në uzinën koksokimike

Në repartin e koksifikimit

Makinist i vendosjes së koksit (rrampo)

- Makinist i sitës së koksit.
- Inxhinier ose teknik remonti në bateri.
- Mekanist e ndihmës i shtytësit të koksit.
- Makinist e ndihmës i rrjetave drejtuese.
- Teknolog i sallës së komandimit

Në repartin e lëndës së parë.

- Punëtor në transportierët nr.1,3.

- Punëtor të copëtuesit nr.1 dhe 2.

Në repartin kimik

- Teknolog ventilimi kryesor e ndihmës
- Teknolog kondensues
- Teknolog seturatori kryesor e ndihmës
- Centrifugist
- Teknolog tharësi e zëvendës
- Teknolog distilimi të benzolit kryesor e ndihmës
- Teknolog i zbrasjes së sqfurit
- Teknolog tiosulfatit dhe sulfocianurit
- Teknolog i dërgimit të sqfurit nga reaktori
- Teknolog i shkumës së sqfurit
- Koncentruues i sqfurit
- Punëtorë e manovrues fenoli, kryesorë e ndihmës
- Punëtorë analizues fenoli
- Distilues katrani kryesore e ndihmës
- Manovrues kondensati
- Pompist katrani, benzoli, sqfuri, ventilimi
- Punëtorë të brendshëm transporti teknologjik
- Shinashtues në baterinë koksit
- Mekanik, elektrikist, hidraulik, në repartet metalurgjike, kimike e të lëndës së parë
- Shpëtuesit
- Përgjegjës e inxhinier ndërrese e reparti në repartet teknologjike
- f) Në uzinën e reparteve refraktare
- Punëtor në repartin përgatitor
- Punëtor në mullirin me sfera
- Punëtor në pompat pneumatike
- Punëtor në sitat vibruese
- Punëtor në mullirin unazor

g) Në uzinën energjetike

Në repartin e kaldajave në TEC

- Makinist i mullirit në kaldaja

Në repartin e lëndës së parë

- Punëtorë të transportierëve nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 në sitën e qymyrit dhe copëtuesin e qymyrit.

Në repartin e oksigjenit

- Kompresoristë e punëtorë mirëmbajtjeje në kompresorët centrifugalë të ajrit me prodhimtari 21000 m³ Nh dhe në kompresorët e oksigjenit me prodhimtari 3600 m³ Nh.

- Mekanik, elektrikist, hidraulik të mirëmbajtjes e remontit në repartin e kaldajave, në repartin në repartin e kompresorëve, repartin e lëndës së parë, në repartin e gazit, në kompresorët centrifugalë dhe të oksigjenit në repartin e oksigjenit dhe të rrjetit inxhinierik e në objektin 191.

- Muratorët e remonteve të furrave e kaldajave.

- Përgjegjës e teknolog ndërrese në TEC, në repartete e kaldajave e të lëndëve të para.

gj) Në repartin e inspektim-shpëtimit nga gazi.

- Shpëtuesit, komandanti dhe inxhinieri e repartit.

h) Në uzinat e ferrokromit

1. Punëtorë të muratimit të kovave, veshjes së furrave e ulluqeve, thyerjes së ferrokromit, copëtimit e sitosjes, dozimit të lëndës së parë, të repartit të gazit e avaroshpëtuesit, punëtorë të mirëmbajtjes e remontit të furrave e pajisjeve teknologjike.

2. Punëtorë të seleksionimit të ferrokromit, manovromit të sistemit hidraulik, elektrodave me rrymë të furrave të shkrirjes, përgjegjës reparti, ndërrese, teknolog në repartet e shkrirjes, gazit e bronzit.

II. Për zbatimin e këtij vendimi Sigurimeve Shoqërore u jepen 4,5 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, parashikuar në buxhetin e shtetit për vitin 1993.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.4.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi